

Bashkia Lushnje, pjesë të strukture së saj organizatike ka Njësinë për Hartimin e Projekteve dhe Integrimin European. Përpos shkrimit dhe zbatimit të projekteve në veprimtarinë e saj Njësia zhvillon edhe aktivitete që lidhen me njohjen dhe procesin e Integritimit Evropian.

Kryesisht aktivitetet e zhvilluara mbështeten nga projekti “Bashkitë për në Europë” dhe EU4Municipalities”. Këto aktivitete Njësia i publikon në faqet zyrtare si : Platforma e Bashkitë për në Europë

Facebook : Njësia Integritimit European-Bashkia Lushnje


Instagram : Njësia Integritimit Evropian

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100064850371088>

The image shows a composite of three screenshots from a Facebook page. The leftmost screenshot displays the profile of 'Njësia Integritimit European - Bashkia Lushnje', which has 475 likes and 553 followers. The middle screenshot shows a post titled 'Kreu' (The Head) about the 'Bashkitë për në Evropë' project, funded by the EU. The text of the post states: 'Mirësevini në platformën e brendshme të komunikimit të Koordinatorëve të BE në 61 bashkitë e Shqipërisë. Objektivi i kësaj platforme të brendshme komunikimi është që ti bëjmë informacionet, dokumentat dhe materialet e ndryshme të projektit, të aksesueshme për të gjithë ju në të njëjtën kohë, si dhe ti japim vetes një hapësirë të përbashkët komunikimi dhe shkëmbim. Ju ftojme të shtroni pyetjet tuaja për çfarëdo çështje që ju mendoni se është e rëndësishme në lidhje me BE, menaxhimin e Këndit të BE në bashkinë tuaj dhe për punën tuaj të përditshme si administrator të Këndit të BE në bashkinë tuaj. Ju ftojme gjithashtu të lexoni me vëmendje të gjitha materialet në no shërbime në këtë platformë.' The rightmost screenshot shows the profile of 'njie_lushnje' with 218 posts, 276 followers, and 73 following. It also features a 'Professional dashboard' and a grid of images related to EU projects like 'EU Summer...', 'Europe wee...', 'Winners', 'Erasmus+', and 'Klubi leximit...'.

Gjatë vitit 2023 janë organizuar këto aktivitete :


-Dita Ndërkombëtare për të thënë FALEMINDERIT- Njësia Integritimit European nisi vitin 2023 me këtë ditë që e organizuan me maturantët e shkollës "Jani Nushi," ku të gjithë së bashku shprehëm mirënjohjen dhe FALENDERIMET fillimisht duke dashur veten, e më pas për miqtë që na kanë mbështetur dhe qëndruar pranë në çdo kohë



-Dita Botërore e Logjikës- Njësia Integrimit Evropian zhvilloi aktivitet me lojra logjike me nxënësit e shkollës “4 Dëshmorët”. Kjo datë u caktua nga Kombet e Bashkuara Arsimore dhe Kulture mbajtur më 26 nëntor 2019, për të sjellë histori intelektuale, implikime praktike dhe rëndësi konceptuale të logjikës për të sjellë në vëmendje të komuniteteve shkencore si dhe publikut të gjerë



- **Dita Ndërkombëtare e Edukimit**, ku Njësia Integritimit Evropian organizoi një aktivitet përgjatë Javës së “Kongresit të Lushnjes”, e cila shënon një ngjarje të rëndësishme historike për qytetin e Lushnjes. Ne kërkojmë të edukojmë dhe sensibilizojmë të rinjtë mbi trashëgiminë dhe vlerat historike e artistike të qytetit të Lushnjes duke krijuar një album fotografish nga ata vetë, e cila do të shërbejë si pikënisje për ndërtimin e historive të reja.



-**Dita Botërore e Drejtësisë Sociale**- Ashtu siç na flet dhe vetë emri, Dita Botërore e Drejtësisë Sociale njihet nevojën për të promovuar drejtësinë sociale, e cila përfshin përpjekje për të trajtuar çështje të tilla si varfëria, gjithëpërfshirja, barazia gjinore, papunësia, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja sociale. Njësia Integritimit Evropian, zhvilloi aktivitetet në kuadër të kësaj dite pranë shkollës së mesme Jani Nushi. Në këtë aktivitet të rinjtë improvizuan se drejtësi sociale ekziston në shtresa të ndryshme ekonomike, besimin fetar, kulturën, arsimin etj...

Dita botërore e drejtësisë sociale është një thirrje për të gjitha vendet në mënyrë që veprimet e sakta tu japin kuptim vlerave botërore dhe dinjitetit njerëzor

- ➡ Të drejta të barabarta
- ➡ Mundësi të barabarta
- ➡ Trajtim i barabartë

Këto tre koncepte janë dhe vlerat thelbësore që përpiqet të promovojë kjo ditë:



- **Dita Ndërkombëtare e Gjuhëve Amtare** - Njësia Integritimit Evropian, organizoi sot aktivitetet me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Foto Puka” mbi një ngjarje të rëndësishme që unifikoi sistemin tonë kombëtar arsimor. Kongresi Arsimor i Lushnjës 15-29 gusht 1920!

Dr. Niko Ferro, Përgjegjës i Muzeut Historik informoi të rinjtë mbi vendimet që morën në këtë Kongres dhe rëndësinë kombëtare mbi proceset mësimore dhe tekstet e shkollave tonë në gjuhën shqipe.



- Njësia Integritimit Evropian ju bashkua nismës së takimeve informuese që NjvksH Lushnje po organizon me takime informuese mbi vaksinimin kundër HPV, në shkolla me nxënës dhe prindër

Në këtë takim, në shkollën 9 vjeçare “ Riza Ibrahliu” Zhamë, Njësia Administrative Dushk, u distakutua mbi të dhënat dhe informacionet që vendet e Bashkimit Evropian ofron për vaksinimin kundër HPV. Vaksinat që mbrojnë ndaj kancerit të qafës së mitrës janë falas në çdo qendër shëndetësore për vajzat 13 vjeçare.



“Dita e Diskriminimit Zero”, duke krijuar kështu një lëvizje globale të solidaritetit dhe bashkëpunimit për t’i dhënë fund të gjitha formave të diskriminimit. Kjo është një ngjarje mbarë botërore e cila ka si qëllim të promovojë përfshirjen dhe diversitetin dhe të festojë të drejtën e gjithsecilit për të jetuar një jetë të denjë dhe të barabartë.

Njësia Integritimit Evropian zhvilloi aktivitetet sot në shkollën 9 vjecare Liri Kazazi me një nga klasat e VIII , duke ju dhënë nga një teks me situata të ndryshme dhe nxënësit do të interpretonin këto situata nëse personazhi ndodhej në situatë diskriminimit.



--Dita Ndërkombëtare të përdoruesve të karrocës” Njësia Integritimit Evropian , në shenjë solidarizimi u bashkua me Qendrën e Zhvillimit gjatë trajnimit që fëmijët me aftësi të kufizuara kryejnë orët e fizioterapisë pranë kësaj qendre



-Dita Botërore e Shkrimtarëve Njësia Integritimit Evropian zhvilloi aktivitetet me nxënësit e shkollës “Skënder Libohova” duke krijuar nga ata vet shënues për librat/ bookmarks 🇷🇸 Në këtë formë kreative nxënësit krijuar me figura dhe vizatime të ndryshme shënuesit e librave , duke mësuar mbi dashurinë për librat.



- Në kuadër të **ditës Botërore të shkrimtarëve** stafi i Bashkisë Lushnje dhuroi disa libra nga shkrimtarë Lushnjarrë dhe jo vetëm në bibliotekën e shkollës së mesme “Pali Dani”, Gorre , Njësia Administrative Kolonjë.



-15 marsi njihet si **Dita Ndërkombëtare e Konsumatorit**, që për qëllim ka mbrojtjen e konsumatorëve. Mbrojtja, ka të bëjë me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve, si dhe me mbrojtjen e tyre nga çdo praktikë abuzive e tregtarëve. Njësia Integritimit Evropian zhvilloi aktivitetet me nxënësit e shkollës “4 Deshmoret” ku informoi mbi balancet dhe vlera ushqimore për secilën prej tyre.



21 Mars, Dita Ndërkombëtare Kundër Diskriminimit Racial -Njësia Integritit European zhvilloi sot një aktivitet në shkollën Jani Nushi, ku nxenesit nepermjet vizatimeve dhane ide se si mund te jete nje qytet pa diskriminim racial. Ata shkruan dhe shprehje se ku ka barazi midis etnive ka edhe harmoni dhe page.



- Kampionati i futbollit e shkollat e mesme

Njësia e Integritit Evropian nisi edicionin e dytë të kampionatit të futbollit për shkollat e mesme në Lushnje gjatë muajit mars-prill në bashkëpunim me Zyren Vendore të Arsimit dhe Kolegjiumin e Arbitrave të qytetit.



- Java Evropiane 2023

Njësia e Integrimit Evropian nisi takimet me nxënësit e shkollave të Bashkisë Lushnje për të ftuar talentet e Lushnjes për të pikturuar në një nga zonat më të reja të rehabilituar nga Bashkia Lushnje, vizatime murale pranë zonës së Ish Depos dhe përgjatë Bulevardit "Shëtitorja e Palmave" për të dhënë mesazhe nëpërmjet vizatimeve murale mbi Javën Evropiane.

Gjithashtu të apasionuarit pas fotografisë, ftohen të marrin pjesë duke dërguar foto nga qyteti i Lushnjes i zbukuruar për festën e Javës Evropiane, së bashku me një përshkrim mbi fotografinë.

Në muajin Maj		Lushnje	EUROPEAN COMMISSION	EUROPEAN UNION
1	Dt. 16	Sheshi i Qytetarëve me flamur të BE - 16 Maj 2023 (zbukurimë sheshin para Bashkisë Lushnje me flamur të Bashkimit Evropian)		
2	Dt. 17	Vizatime murale - 17 Maj 2023 me nxënësit e të gjithë shkollave të qytetit që ndajnë mesazhe me logo të "Europa Week 2023", në zonat e rehabilituara të qytetit.		
3	Dt. 19	Atmosfer festive - 18 Maj 2023 (në sheshin e Bashkisë Lushnje) vendosim çadrat blu dhe të verdha duke krijuar flamurin Evropian.		
4	Dt. 22	Vizatime murale (part 2) - 19 Maj 2023 talentet në pikturë vizatojnë në muret e shëtitores "Bulevardi i Palmave" dhe Oqeanës Multikulturale Kinore mesazhin "Europa këtu 2023."		
5	Dt. 25	Photo story - 25 Maj 2023, të apasionuarit pas fotografisë, dërgojnë foto nga qyteti i Lushnjes në atmosferën e festimeve të Javës Evropiane 2023 dhe krijojnë "Fotostorën" e parë në qytet.		
6	Dt. 26	Festë në qytet - 26 Maj 2023, festojmë mbylljen e Javës Evropiane 2023 duke vlerësuar të gjithë pjesëmarrësit në këto aktivitete.		








EUROPA ËSHTË KËTU!

EUROPE WEEK 2023





23 Qershor Dita e Shërbimit Publik (OKB) - Njësia e Integritit European Bashkia Lushnje, zhvilloj një aktivitet në ambientet e Bashkisë duke shpërndarë fletëpalosje për t'u informuar më shumë rreth kësaj dite, por edhe për të mbështetur dhe vlerësuar nëpunësit publik për punën e tyre të përditëshme.



**Njësia Integrimit European nisi edhe për këtë verë
EU Summer School 2023 EU me mbështjen e projektit “Bashkitë për në Europë.**




-Dita e pare: Në Kalanë e Beratit, ku u bashkuan të rinjë, pjesë e shkollave verore të Bashkisë Lushnje, Bashkisë Berat dhe Bashkisë Përmet. Gjatë ditës së sotme të rinjtë u socializuan me njëri-tjetrin, ndanë eksperencat për qendrat rinore të qyteteve të tyre.



Dita e dytë

Në këndin sportiv pranë gjimnazit "18 Tetori" Lushnje të rinjtë e shkollës verore në pjesën e parë të ditës së dytë zhvilluan aktivitete sportive duke dhënë mesazhin se aktivitetet sportive janë të domosdoshëm për një shëndet të mirë dhe aktiv dhe në pjesën e dytë të kësaj dite, organizoi takimin me të rinjtë e shkollës verore 2023, pranë Qendrës Rinore Multifunksionale për të ndarë eksperencat e tyre me programet për rinin që BE ofron.



Dita e tretë

Mirëpritëm sot në Qendrën Rinore Multifunkionale të Bashkisë Lushnje, Dr.Zemaida Mozali, eksperte e politikave të BE-së, e cila diskutoi mbi Integrimin European të Shqipërisë dhe rëndësinë e integrimit në nivel vendor.



Dita e katërt :

Në Përmet , ku të rinjtë pjesëmarrës u njohën me pikat turizike të qytetit; njohën projektet që qyteti i Përmetit ka fituar dhe po zbaton dhe së bashku me të rinjtë e Përmetit shkëmbyen eksperiencat e tyre me programet rinore që BE ofron.




Dita e pestë

Të rinjtë u informuan mbi projektet që Bashkia Lushnje ka fituar dhe po zbaton me mbështetjen nga Bashkimi Europian, këta të rinjë mësuan sot praktikën e shkrimit të një projekt-propozimi sipas standarteve të BE-së, duke propozuar ide inovatore për të rinjtë dhe komunitetin në Lushnje



Dita e gjashtë

Takim informues me organizatën fituese të thirrjes së dytë në bashkëpunim me ReLOaD2, Qendra "Strehëza Edlira Haxhiymeri"- SEH, të cilët informuan të rinjtë mbi shërbimin e ndihmës dhe diskutuan pikëpamjet e tyre mbi shërbime të ndryshme në funksion të rinisë, së bashku me përfaqësues të projektit RISIA Albania dhe Keshillimi i Karrieres, informuan të rinjtë pjesë e shkollë mbi shërbimin e këshillimit të karrierës për të gjithë të rinjtë lushnjar që "Bashkia Lushnje" shumë shpejt do të ofrohet prej saj.



Dita e shtatë

Në këtë ditë të fundit të shkollës verore për vitin 2023 e nisi me aktivitet interaktive nga Shtëpia e Evropës, loja “Mos u nxeh” e cila promovon trashëgiminë kulturore si dhe zakonet e traditat e krahinave të qyteteve të ndryshme në Shqipëri. Në përfundim të këtij rrugëtimi të bukur , Kryetarja e Bashkisë Lushnje, znj.Eriselda Sefa , shpëndaue certifikata për të gjithë të rinjtë pjesëmarrës, si një dëshmi për të gjithë informacionin e përfituar në ambientet e Qendrës Rinore Multifunksionale - Bashkia Lushnje.



-Java Evropiane e Sportit

Njësia Integritimit European organizoi sot aktivitet sportiv në bashkëpunim me Qendrën e Zhvillimit Lushnje për të promovuar vlerat e veprimtarive fizike dhe sportive për një jetë sa më të shëndetshme, ku më mirë se përmes fëmijëve me aftësi ndryshe të cilët japin shëmbullin se sporti është mënyra më e shëndetshme e jetesës dhe nxënësit e shkollës së mesme "18 Tetori" Lushnje -përmes aktiviteteve sportive dhe mesazhe të Javës Evropiane të Sportit për t'u inkurajuar dhe investuar në shëndetin tonë për të sjellë ndryshime pozitive në jetën tonë nëpërmjet sportit dhe aktiviteteve fizike



-Dita Nderkombetare e OKB-se. Tematika per kete vit ishte "Veprimi sa me i shpejte ndaj klimes per nje planet me te mire.Njesia e Integritimit European zhvilloi nje aktivitet ne shkollen 9 vjeçare "4 Deshmoret" nxenesit u informuan mbi kete dite ,krijimin e OKB-se si edhe qellimin kryesor te saj



-Dita Ndërkombëtare e Tolerances -Vetëm një ditë më vonë Asambleja e Përgjithshme e OKB -së, vendosi që 16 Nëntori të ishte Dita Ndërkombëtare e Tolerancës.Në formë ndërjegjësimi Njësia e Integritimit Europiane organizoi një aktivitet në ambientet e Bashkisë.



-10 dhjetori shënon Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut- Me rastin e kësaj dite Njësia e Integrimit European në Bashkinë Lushnje organizoi një aktivitet me nxënësit e shkollës Liri Kazazi të cilët u njohën dhe lexuan pjesë nga kjo Deklaratë



-20 Dhjetor- Dita Ndërkombëtare e Solidaritetit Njerëzor

Njësia e Integritimit Europian në Bashkinë Lushnje organizoi një aktivitet në formën e një bashkëbisedimi ndërgjegjësues me nxënësit e klasës së 10 të gjimnazit "Jani Nushi" të cilët folën për rëndësinë e kësaj dite në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm duke përfshirë zhdukjen e varfërisë.

